

Komuna e Rahovecit/Orahovac

Veseli (Beqë) Krasniqi

(9.01.1951, shqiptar nga Pastasella/Pusto Selo, komuna e Rahovecit/Orahovac, pylltar, gjashtë fëmijë)

Veseli ka punuar si pylltar në Drejtorinë e Pyjeve në Rahovec/Orahovac. Ditën e pacaktuar të muajit **prill të vitit 1998**, kur ai u zhduk, Veseli u nis si zakonisht në punë [nga **Pastasella/Pusto Selo**]. Nga ajo ditë, atij i humbet çdo gjurmë. Në datën 7.05.1998, familjarët mësuan se trupi i pajetë i Veselit ishte zbuluar dy ditë më herët, rreth orës 10:00, pranë rrugës në fshatin Tërstenik/Trstenik [Glogoc/Glogovac]. Në trupin e viktimës dalloheshin qartazi vrimat nga plumbat dhe prerat e thikës. Në datën 12.05.1998, kolegu i Veselit, pylltari Bogi, e ka marr trupin e viktimës nga morgu i Prishtinës/Pristina dhe e ka çuar te familja. Po atë ditë, varrimi i Veselit u bë në varrezat e Pastasellës/Pusto Selo.

Burimet: deklaratat Z.K, FDH-33070; SMIP, *Teroristički...*, III, 40, 910; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Dnevnik od 5. do 11. maja*, Ilustrovana politika, 06.06.1998, FDH-32198.

Milaim (Isa) Krasniqi

(25.03.1967, shqiptar nga Pastasella/Pusto Selo, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Milaimi e kishte mbaruar shkollën e lartë të hotelerisë në Sarajevë [Bosnjë dhe Hercegovinë]. Që nga shpërthimi i luftës në Kosovë, Milaimi ka qëndruar në *Drenicë/Drenica*. Familjarët e tij mësuan se Milaimi ishte pjesëtar i UÇK-së vetëm kur ai një ditë, erdhi te shtëpia i veshur në uniformë

ushtarake. Në datën **12.05.1998**, Milaimi u plagos rëndë në këmbë gjatë betejës me forcat serbe në fshatin **Bratotinë/Bratotin**. Bashkëluftëtarët e bartën menjëherë në spitalin e UÇK-së, por Milaimi ndërroi jetë nga plaga e rëndë. Familjarët e kanë varrosur Milaimin në varrezat e Pastasellës/Pusto Selo më 13.05.1998.

Burimet: deklaratat M.K, FDH-17933; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816; SHFDUÇK, *Feniksët...*6, 201-205; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092.

Aleksandar (Stajko) Micić

(22.11.1969, serb nga Hoça e Madhe/Velika Hoça, komuna e Rahovecit/Orahovac, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas mbarimit të shkollës së mesme dhe trajnimit për oficer policie në vitin 1990, Aleksandri filloi nga puna si pjesëtar i policisë rrugore pranë Stacionit Policor në Rahovec/Orahovac. Në datën **12.05.1998**, UÇK-ja e ka sulmuar stacionin policor në **Ratkoc/Ratkovac** dhe ka shtënë mbi shtëpitë serbe. Aleksandri me tre kolegë të vet ishin në patrullë, e cila kishte për detyrë t'i evakuonte policët e sulmuar si dhe civilët e mbetur në fshat. Ka gjetur vdekjen në hyrje të fshatit nga drejtimi i Bratotin/Bratotin, përderisa dy kolegë të tij u plagosën. E varrosën në Hoçën e Madhe/Velika Hoça më 13.05.1998.

Burimet: deklaratat V.Đ, FDH-467; deklaratat S.M, FDH-471; deklaratat A.G, FDH-34690; Prokurori Ushtarak në Nish, VTK, num. 403/2000 (B.Susuri dhe të tjerë), akta-kuza, 12.04.2000, FDH-1473; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci*